**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AVOKATI I POPULLIT**
**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,**
**Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

**Nr. K4/I21-2 Prot.** **Tiranë _30__/_07__/2025**
**Nr. Dok. 202502502/2**

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Drejtorisë/Komisariatit të Policisë Korçë.*

**Drejtuar:** **Z. Erion AHMETI**
**Drejtor i DVP Korçë**

**KORÇË**

**Z. Agim Hoxha**
**Shef i Komisariatit të Policisë Korçë**

**KORÇË**

**Për dijeni:** **Z. Ilir PRODA**
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që Institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë Korçë më datë 13.03.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *"Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar kreu këtë inspektim në Komisariatin e Policisë Korçë. Në përbërje të grupit inspektues ishin Hazbi Selita dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024, *"Për Policinë e Shtetit"*, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894,

datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Inspektimi ishte paparalajmëruar.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

**Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisariatit të Policisë Korçë, z. Agim Hoxha, i cili u vu në dijeni në lidhje me qëllimin e inspektimit.

Drejtuesi i komisariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me respektimin dhe trajtimin e shtetasve gjatë qëndrimit të tyre në mjediset e komisariatit në cilësinë e të shoqëruarve dhe të ndaluarve/arrestuarve, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve ndërkombëtare për këtë qëllim, plotësimin e kushteve në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me përgjegjësin e dhomave të sigurisë dhe punonjësin e zyrës së informacionit të dhomave të shoqërimit, inspektoi mjediset ku mbahen dhe trajtohen personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, verifikoi dhe administroi dokumentacionin që plotësohej prej punonjësve të policisë sipas procedurave standarde, vizitoi zyrat e specialistëve të policisë të këtij institucioni që kryejnë veprime procedurale me shtetasit e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, si dhe zhvilloi intervista konfidenciale me personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, në lidhje me respektimin e të drejtave dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave.

Nisur nga informacioni i drejtuesve të policisë, por dhe nga inspektimi i kryer në mjediset e sigurisë dhe të shoqërimit në këtë komisariat, rezultoi se respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria dhe kushtet infrastrukturore në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, në tërësi ishin sipas kritereve, normave dhe parametrave teknike të parashikuar në procedurat standarde, që garantojnë sigurinë dhe trajtimin e këtyre personave.

Lidhur me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar[1], rezultoi se:

- Ishte zbatuar zbatuar pjesërisht rekomandimi, për krijimin e zyrave të përshtatshme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga

[1] Shkresa me nr. K4/I30-2 prot., datë 29.07.2024, "*Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Drejtorisë/Komisariatit të Policisë Korçë*."

oficerët e policisë gjyqësore kjo referuar fluksit pritës të personave shoqëror/arrestuar në këtë komisariat[2].

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e dhomës për depozitimin e provave materiale, të cilat duhet të administrohen dhe ruhen në ambiente/dhoma të ndara për këtë qëllim sipas rregullave e procedurës standarde.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për ndërtimin e tualeteve të ndara për gra dhe burra të pajisura me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim sipas parashikimeve në procedurën standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e ambientit të ajrimit për personat e arrestuar në këtë komisariat.

Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se këto rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varen nga njësia vendore, por çdo komisariat duhet të demostrojë se ka qenë konsekuent në kërkimin e fondeve.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se në ambientet e Komisariatit të Policisë Korçë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

**Ambienti i shoqërimit dhe kushtet e tij**

Ambienti i shoqërimit në Komisariatin e Policisë Korçë, ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024, *"Për Policinë e Shtetit"*, dhe procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku parashikohet se: *"Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur. Këto mjedise të jenë brenda ndërtesave të drejtorive, komisariateve dhe stacioneve të policisë"* [3].

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së komisariatit dhe përbëhej nga 2 (dy) dhoma shoqërimi, të ndara për personat e rritur dhe për gra. Ndërsa, intervistimi i të miturve kryhej në ambientet e Njësisë për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje, i cili përbëhej nga 3 dhoma. Dhomat e këtij ambienti ishin të kompletuara me tavolina pune për punonjësit e policisë, psikologun, avokatin mbrojtës dhe përfaqësuesin ligjor, si dhe me orenditë e nevojshme si kolltuk e karrige për qëndrimin komod dhe ulur të të miturve. Ky investim ishte

[2] Kthim përgjigje të shkresës tonë me numër 7424/1 prot, datë 25.10.2024 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

[3] Kreu VI, pika 4, gërmat b dhe c të procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë",* miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

kryer në kuadër të një programi bashkëpunimi midis DPPSH-së me organizatën "Save the Children".

Dhomat e shoqërimit ishin me përmasa 4x5m$^2$ secila prej tyre, me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave, të kompletuara me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige me këmbë të fiksuara dhe të pa lëvizshme, për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve me kapacitet deri 10 persona, me kushte normale për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që iu njeh ligji këtyre personave.

Dhomat kishin dritare me xham, të siguruara në pjesën e jashtme me skarë hekuri. Përmasat e dritareve ishin të tilla që krijonin mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral, si dhe kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Mjediset e dhomave të shoqërimit ishin të mirëmbajtura, por kishin nevojë për lyerje dhe për t'u mbajtur pastër nga ana higjieno-sanitare në mënyrë të vazhdueshme. Një gjendje e tillë është faktor i shtuar për trajtim jo dinjitoz të personave të shoqëruar.

Ne vlerësojmë se kushtet higjieno-sanitare janë shumë të rëndësishme në ambientet e privimit të lirisë dhe gjendja e tyre varet nga organizimi i punës dhe për këtë shkak Avokati i Popullit kërkon vëmendje maksimale nga drejtuesit e komisariatit dhe stafi përgjegjës. Pastërtia e ambienteve është thelbësore pasi tregon qartë kujdesin ndaj të shoqëruarve dhe është e përballueshme nga pikëpamja e kostove.

Në Komisariatin e Policisë Korçë **nuk kishte tualete të ndara më vete për gra dhe burra** sipas parashikimeve në procedurën standarde[4] *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në korridorin e këtij ambienti, ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodheshin 2 (dy) tualete nga të cilët vetëm njëri ishte funksional, ndërsa tualeti tjetër ishte i mbyllur dhe jashtë funksionit. Përgjatë inspektimit konstatuam se tualeti funksional ishte i pajisur me nyje hidrosanitare, dhe furnizohej rregullisht me ujë të rrjedhshëm, por konstatuam se në këtë ambient mungonte ndriçimi dhe dera e tualetit ishte e dëmtuar.

Korridori i këtij ambienti dhe dhomat e shoqërimit ishin të monitoruara me kamera, për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me të shoqëruarit. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 30 ditë. Ky afat është në kundërshtim me "Rregulloren për vendosjen dhe përdorimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjediset e brendshme dhe të jashtme, të objekteve ku ushtrojnë aktivitetin strukturat e Policisë së Shtetit"[5], në të cilën është e përcaktuar qartë se: *"Regjistrimet e kamerave të sigurisë do të ruhen për një periudhë deri në 60 ditë dhe më pas do të fshihen automatikisht"*.

[4] Kreu VI, pika 4, gërma e pika e.2 e procedurës standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë",* miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

[5] Miratuar me Urdhrin Nr.1301, datë 03.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë inspektimit u evidentua se situata me njohjen e të drejtave të personave të shoqëruar në konflikt me ligjin ishin përmirësuar dukshëm në këtë komisariat, ku në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, të cilët ishin të afishuar edhe brenda dhomave të shoqërimit, me qëllim që të jenë të aksesueshëm nga personat e shoqëruar për t'u njohur me këto të drejta. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Në momentin e inspektimit në ambientin e shoqërimit ishte një shtetas i shoqëruar, i cili nga intervista na informoi se ishte trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së shoqërimit në komisariat. Ndërkohë shtetasi i shoqëruar na informoi se kishte rreth një orë që ishte në ambientet e Komisariatit të Policisë Korçë dhe pritej të merrej në pyetje nga specialistët/oficerët e policisë gjyqësore. Gjithashtu, personi i shoqëruar nuk paraqiti asnjë ankesë për keqtrajtime nga punonjësit e policisë gjatë shoqërimit të tij në komisariat dhe qëndrimit në ambientet e dhomave të shoqërimit.

Nga komunikimi me punonjësit e shërbimit në zyrën e informacionit, konstatuam se **personave të shoqëruar ju jepej një kopje e kartës me të drejtat e tyre në momentin që ata hynin në dhomat e shoqërimit.** Ky konstatim u pohua edhe nga personi i shoqëruar përgjatë bisedës me ekipin e Avokatit të Popullit.

Në Komisariatin e Policisë Korçë gjatë periudhës **01.01.2025** deri më **13.03.2025** ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **297** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit "Për Policinë e Shtetit", ku saktësisht ishin të shoqëruar **287** shtetas madhorë, **9** gra dhe **1** mitur konflikt me ligjin.

Në Komisariatin e Policisë Korçë kishte një dhomë intervistimi, e cila ishte e pajisur me dy karrige, një tavolinë dhe një kompjuter, si dhe ishte e monitoruar me kamera dhe sistem audio. Kjo dhomë i plotëson standardet e kërkuara, **por** referuar kapaciteteve ishte e pamjaftueshme për të mbuluar punën e 11 oficerëve të policisë gjyqësore me personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar. Për këtë arsye, pjesa më e madhe e oficerëve të policisë gjyqësore vijonin praktikat e marrjes në pyetje në zyrat e tyre, në kundërshtim të hapur me Kreun VI, pika 4, gërma "i" të procedurës standarde të punës "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pasi nuk plotësojnë kushtet e parashikuara më poshtë.

Në procedurën standarde të punës "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përkatësisht në Kreun VI, pika 4, gërma "i" përcaktohet qartë se:
*"i. Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme si*:
*i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).*
*i.1.1 Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe këto kushte:*

*-Të ketë të instaluara tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj).*
*-Tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohet, etj.*
*-Instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar."*

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e vetë punonjësit e policisë së shtetit ashtu dhe nga të shoqëruarve në konflikt me ligjin.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar[6] në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar plotësisht pasi duhet të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit.

Ndërkohë, vlerësojmë se në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda si: dhunime fizike, torturë apo të rasteve fatale të vdekjeve në ambientet e organeve të policisë, regjistrimi dhe ruajtja e filmimeve do të ishte një nga provat e rëndësishme për zbardhjen dhe identifikimin e autorëve të tyre. Me anën e regjistrimit audio-viziv mund të verifikohet dhe provohet nëse i arrestuari/ndaluari ka qenë ose jo i dhunuar para se të shoqërohej në organet e policisë, gjatë marrjes në pyetje para se të akomodohej në dhomat e sigurisë, apo është dhunuar brenda këtyre ambienteve, personat që e kanë takuar apo dhunuar, datën dhe orën e kryerjes së veprimeve të kundërligjshme, kryerjen e detyrave nga punonjësit e policisë të shërbimit të brendshëm, ofrimi i shërbimit mjekësor, etj. Për këto arsye, është domosdoshmëri monitorimi dhe ruajtja e regjistrimeve nëpërmjet të cilit do të mund të shmangen rastet e dhunës fizike apo psikologjike. Në këto kushte vlerësojmë se ka vend për marrjen e masave disiplinore për këtë shkelje të përsëritur të parashikuar të procedurës së ndjekur në garantimin e lirive e të drejtave të individit.

Nga informacioni i punonjësit të policisë në zyrën e informacionit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, në këtë komisariat zbatohej detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024, "*Për Policinë e Shtetit*", si dhe në kapitullin VII, pika

[6] Shkresa me nr.K4/I30-2 prot., datë 29.07.2024, "*Rekomandohet krijimi i ambienteve (dhomave) më vete të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit*".

a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e një kopje të procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit, nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. U evidentua gjithashtu se, për personat e shoqëruar mbahej edhe "*Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit*", nga punonjësi i policisë që kryente shoqërimin në mjediset e komisariatit, ku përcaktohet përveç të dhënave edhe shkaku i shoqërimit, koha e qëndrimit të personit në këto ambiente dhe pretendimet e të shoqëruarit në lidhje me trajtimin nga punonjësi i policisë.

Kjo praktikë është në përputhje me të drejtën për informim që gëzojnë shtetasit e shoqëruar në momentin e parë të shoqërimit, referuar rekomandimeve të Avokatit të Popullit, por edhe raportit me rekomandime të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT-së), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20-30 Nëntor 2018[7], ku thuhet shprehimisht se, shtetasit që shoqërohen në mjediset e Policisë të Shtetit duhet "*të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria...".* Ndërkohë në përmirësim të këtij standardi ka rëndësi të sigurohet që të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit dinë të shkruajnë e lexojnë të drejtat e tyre.

**Ambienti i sigurisë, kushtet e tij dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve**

Në Komisariatin e Policisë Korçë dhomat e sigurisë ishin përgjithësisht të ndërtuara sipas kërkesave të parashikuara në procedurën standarde *"Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023.

Ambienti i sigurisë përbëhej nga 6 (gjashtë) dhoma sigurie, me kapacitet për 6 (gjashtë) persona. Ato ishin të ndara në 4 (katër) dhoma për personat burra, 1 (një) dhomë për gra dhe 1 (një) dhomë për të mitur.

Dhomat e sigurisë janë të ndërtuara përgjithësisht sipas parametrave teknik të përcaktuar në procedurën standarde, të ndara në dy ambiente me një skarë hekuri dhe derë, në ambientin për fjetje dhe në paradhomë. Nisur nga hapësira dhe sipërfaqja e secilës dhomë, ato plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 metra katrorë, ambienti i qëndrimit me sipërfaqe 6 m² dhe paradhoma me sipërfaqe 4 m².[8]

Çdo dhomë ishte e pajisur me një krevat metalik me këmbë të palëvizshme dhe ishte e kompletuar me dyshek, batanije dhe jastëk. Në ambientin e qëndrimit ndodhej dhe tualeti,

[7] shih*: https://rm.coe.int/16809cb571 "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania*)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).

[8] Kreu VII, pika 3.3 e Urdhrit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".*

ndërsa në paradhomat e çdo dhome sigurie ndodhej një lavaman me çezmë që kishte ujë të rrjedhshëm, i cili përdorej për pastrimin vetjak.

Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që krijonin mundësinë e depërtimit të ajrit dhe dritës natyrale. Ato furnizoheshin me energji elektrike nga rrjeti elektrik dhe në rast ndërprerje, kishte gjenerator si burim alternativ.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larjen e trupit në një ambient të posaçëm i cili ishte i përbërë nga dy tualete[9], me dush me ujë të ngrohtë, i cili ndodhej brenda korridorit, në ambientin e sigurisë.

Dhomat e sigurisë ngroheshin me sistem qendror të ngrohjes me kaldajë gjatë periudhës së dimrit, sikurse parashikohet në procedurën standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*.

Në korridorin e ambientit të sigurisë, kishte aparat telefoni fiks për të mundësuar lidhjen e punonjësit të shërbimit në dhomat e sigurisë me sallën operative të komisariatit, në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, si dhe për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Në dhomat e sigurisë ishin instaluar buton zile/sinjali të montuara në mur për kontaktin me punonjësin e policisë në rast nevoje e të arrestuarve/ndaluarve,

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma e mjekut, e cila shërben për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar, ruajtjen e dokumentacionit që mbahet prej tij, si dhe mbajtjen e medikamenteve të nevojshme për rastet e urgjencave. Kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit/arrestuarit paraqitet e përkeqësuar, me rekomandimin e mjekut, personi shoqërohet menjëherë për në Spitalin Rajonal të Korçës.

Dhoma ishte e pajisur me shtrat për kryerjen e vizitave mjekësore, tavolinë pune, karrige dhe një raft prej druri i mbyllur me bravë për mbajtjen e regjistrave dhe të barnave mjekësore. Ngrohja e ambientit realizohej me ngrohje qendrore.

Brenda ambientit të sigurisë ndodhej edhe dhoma për marrjen në pyetje të ndaluar/arrestuarve nga prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takimin e këtyre personave me avokatët mbrojtës, e cila ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige me këmbë të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme për qëndrimin ulur të personave, të cilat ofrojnë kushte pune për përfaqësuesit e organit të akuzës, si dhe për avokatin mbrojtës të tyre.

[9] Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre". "Pika 9. Ambienti për larjen e trupit. 9.1 Brenda sistemit të dhomave të sigurisë ndërtohen dhe funksionojnë ambiente të posaçme që shërbejnë për larjen e trupit të arrestuarve/ndaluarve."*

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me 3 kamera, përgjatë 24 orëve. Kamerat administroheshin nga punonjësi i IT-së në DVP Korçë dhe afati i ruajtjes së pamjeve filmike ishte për 30 ditë.

Nga informacioni i punonjësve të policisë dhe intervista e zhvilluar me personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 *"Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre"*. Atyre ju sigurohen 3 vakte ushqim në ditë, që përgatiten nga një subjekt privat sipas kontratës së lidhur me DVP Korçë dhe servirej me shërbim katering.

Shtetasi i intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishte marrë kontakt dhe ishin kryer veprimet procedurale, pasi gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar, duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje e urdhrit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe letrës për njohje me të drejtat e tyre.

Në Komisariatin e Policisë Korçë, zyra për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurorët, që ndodhej në ambientin e sigurisë, ishte e monitoruar me kamera.

Për periudhën Janar –Mars 2025 ishin mbajtur në dhomat e sigurisë në cilësinë e personave të arrestuar dhe të ndaluar, gjithsej 80 persona, nga të cilët 2 ishin gra dhe 1 të mitur. Nga këqyrja e regjistrit, nuk u konstatua asnjë rast mbipopullimi në dhomat e sigurisë.

Sjellim në mënyrë të përsëritur në vëmendjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit se në Komisariatin e Policisë Korçë **nuk kishte ambiente ajrimi.**

Kjo problematikë është konstatuar edhe në Raportin e CPT-së gjatë vizitës në datat 4-15 Maj 2023. Në këtë raport kërkohet në mënyrë të përsëritur[10] ndër të tjera: "*Të gjitha ambientet e policisë të vizituara, përfshirë edhe qendrën e re të paraburgimit në Shkodër, vuajnë një mangësi të madhe strukturore, përkatësisht mungesën e një oborri të jashtëm ushtrimesh. Si rezultat, personat e ndaluar ende nuk kishin mundësi të dilnin në ajrim.* ***CPT-ja përsërit rekomandimin e saj që të gjithë personat e ndaluar në një institucion policor për 24 orë ose më shumë t'u ofrohet ushtrime në natyrë në baza ditore...***" [11].

**Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

[10] Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019). *Konsulto: https://rm.coe.int/168097986b*
[11] Raporti drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, pika 34, fq. 14. Për më shumë shiko:
chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b

Sipas parashikimeve në dispozitat e ligjit nr. 82/2024, *"Për Policinë e Shtetit",* si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *"Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", çdo njësi policore ku ka dhoma shoqërimi dhe dhoma sigurie, duhet të jetë e pajisur me regjistrat përkatës.

Theksojmë se, nga verifikimi i regjistrave dhe librave të shërbimit në Komisariatin e Policisë Korçë, u evidentua se regjistrat ishin të sekretuar dhe vulosur, sikurse përcaktohen në modelet tip të miratuar në procedurat standarde.

Konkretisht, në zyrën e informacionit ndodhej "*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*" sipas tipit "Model nr.1", konform me procedurën standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*".

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*", regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë, por në çdo rast brenda afatit deri në 5 orë. Ndërkohë, përgjatë këqyrjes së këtij regjistri konstatuam se rubrika e regjistrit mbi njoftimin e familjarëve **nuk ishte e plotësuar në mënyrë korrekte,** pasi në regjistër nuk ishte i shënuar emri i familjarit të njoftuar me numrin e telefonit përkatës, por ishte shënuar nga specialisti i policisë vetëm "Njoftuar familjari", shënim i cili nuk identifikon familjarin i cili ka marrë dijeni[12], kjo bazuar në procedurën standarde *"Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë"* miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku në pikën a.1.2 citohet se: *"Në Regjistrin e Evidentimit të Personave të Shoqëruar duhen plotësuar në mënyrë të saktë dhe të qartë të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmve për shoqërimin si: emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vendndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe ora e njoftimit".*

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor në funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Në këtë komisariat mbahej dhe regjistri me të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili gjithashtu ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e

[12] Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë: dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre; sigurimin e aksesit te një avokati; njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin.

policisë njëherësh për Komisariatet e Korçës, Pogradecit, Ersekës dhe Devollit, në varësi të DVP Korçë. Në procesverbalin e arrestimit apo ndalimit, ishte shënuar ora kur personat ishin mbajtur të shoqëruar në mjediset e policisë, pra në momentin kur atyre ju ishte privuar liria.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në këtë Komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*", por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Në këtë institucion administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë muajit janar të vitit 2025 kishte 1 të mitur në konflikt me ligjin, sipas procedurës standarde (Lidhja model 5).

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohej nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe në disa gjuhë të huaja.

**Ambientet e intervistimit**

Në Komisariatin e Policisë Korçë është krijuar një dhomë intervistimi, e cila është e pajisur me dy karrige, një tavolinë dhe një kompjuter. Gjithashtu, ajo është e monitoruar me kamera dhe sistem audio. Megjithatë, kjo dhomë nuk i plotëson standardet e kërkuara, pasi kapaciteti i saj është i pamjaftueshëm për të përballuar punën e të gjithë oficerëve të policisë gjyqësore me personat e shoqëruar apo të ndaluar. Aktualisht, në Komisariatin e Policisë Korçë punojnë 11 oficerë të policisë gjyqësore, të cilët e kanë të pamundur të përdorin këtë dhomë njëkohësisht dhe praktika e marrjes në pyetje në zyrat individuale të oficerëve vijon.

Për këtë arsye, dhoma e intervistimit duhet të përdoret në kapacitet të plotë deri në krijimin e një hapësire tjetër, e cila do të mundësojë realizimin e plotë të këtij procesi në përputhje me standardet e kërkuara.

Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit: "*Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.*

*Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare."*

***CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar***" [13].

Kjo gjetje e CPT-së është në vijim të gjetjeve të bëra prezent nga MKPT dhe Avokati i Popullit të cilët konsiderojnë procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, si thelbësor për parandalimin e çdo forme keqtrajtimi. Monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e vetë punonjësit e policisë së shtetit ashtu dhe nga të shoqëruarve, ndaluarve apo të arrestuarve.

Nga inspektimi i zyrave të punonjësve të policisë të këtij komisariati, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisariat **nuk kishte** një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, ku të mbaheshin të gjitha provat materiale të administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve.

**Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë komisariat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024 *"Për Policinë e Shtetit",* si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 e procedurës standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi, se për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip *"Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit"*. Njëkohësisht, zbatohej detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t'i jepet një kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Në dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale në nenet 34/a, gërma "c" dhe 34/b gërma "a", si dhe në ligjin nr. 84/2024 *"Për Policinë e Shtetit",* në pikën 4 të nenit 19, përcaktohet se: *"Çdo shtetas në momentin e privimit të lirisë në mjediset e Policisë së Shtetit, ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin mbrojtës".*

Në mjediset e privimit të lirisë në Komisariatin e Policisë Korçë, mungonte lista e avokatëve të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, personave të arrestuar/ndaluar iu respektohej e drejta për avokat mbrojtës kryesisht dhe në rastin kur nuk kanë mundësi financiare, kontaktohet salla operative e policisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, për të siguruar avokatët nga lista e avokatëve të miratuar nga organi i prokurorisë sikurse parashikohet në Kodin e Procedurës Penale.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 1 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për

[13] Electronic recording of police intervieës (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, https://rm.coe.int/1680ae233b.

kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të shoqëruarve me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

CPT gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri të zhvilluar në periudhën 4-15 Maj 2023 në institucionet policore, në raportin dërguar autoriteteve të Qeverisë së Shqipërisë, përsa i përket masave mbrojtëse themelore kundër keqtrajtimit të personit (përkatësisht, e drejta e njoftimit për ndalimin dhe e drejta për avokat dhe mjek), ka konstatuar se: "*Delegacioni dëgjoi disa pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e tyre për avokat kryesisht vetëm* ***pas një vonese të konsiderueshme****, në mënyrë që të mund t'i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati. Gjithashtu janë marrë ankesa se* ***avokatët kryesisht nuk kanë ofruar ndonjë ndihmë kuptimplotë****. Për më shumë, informacioni i mbledhur gjatë vizitës sugjeronte se ekzaminimi fillestar mjekësor i personave të ndaluar në përgjithësi ishte ende i kufizuar tek pyetjet për gjendjen e tyre shëndetësore, pa kryer një ekzaminim fizik"*.

Përsa më sipër, CPT ka rekomanduar që: *"Autoritetet shqiptare duhet t'u kujtojnë të gjithë oficerëve të policisë* ***detyrimin ligjor për t'i dhënë akses ndaj një avokati që nga fillimi i heqjes së lirisë së një personi****. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa në konsultim me Dhomën e Avokatëve për t'u siguruar që avokatëve kryesisht t'u kujtohet* ***roli i tyre kyç në parandalimin e keqtrajtimit duke qenë të pranishëm në komisariatet e policisë*** *dhe duke ndërhyrë që në fillim të privimit të lirisë, duke përfaqësuar sa më mirë të munden interesat e personave që janë të mandatuar të ndihmojnë dhe, më konkretisht, duke ndërmarrë veprimet e duhura sa herë që ka tregues se persona të tillë janë keqtrajtuar (ose mund të jenë) keqtrajtuar nga policia. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa për të promovuar, në kuadrin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të avokatëve, një kulturë ku* ***mosndjekja e akuzave për keqtrajtim policor të konsiderohet si joetike dhe joprofesionale****"*[14].

Ndërkohë nga inspektimi, u evidentua gjithashtu një praktikë e mirë në Komisiariatin e Policisë Korçë, që në rastet e shoqërimit apo arrestimit të personit të mitur në konflikt me ligjin, psikologu sigurohej tashmë nga lista e miratuar nga Urdhri i Psikologut, ku pasi njoftohej salla operative e Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, psikologu sigurohej menjëherë sipas listës së miratuar nga institucioni përgjegjës. Gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët e policisë, personit të mitur në mjediset e policisë i ofrohej ndihmë ligjore dhe psikologjike sipas legjislacionit përkatës, në prani të avokatit mbrojtës, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut. Nga informacioni rezultoi se, psikologu paraqitej në ambientet e komisariatit brenda një afati kohor jo më shumë se 1 orë nga ora e njoftimit.

Për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, ishin përgatitur letra me të drejtat e të ndalur/arrestuarve në 6-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht dhe gjuhën rome.

[14] efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e mjedisit të shoqërimit dhe të sigurisë të komisariatit, ishin të afishuara postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Grupi i inspektimit konstatoi se, vizita mjekësore nga ana e mjekut (me kontratë me kohë të pjesëshme) kryhej rregullisht brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurën standarde, si dhe mjeku ishte prezent sa herë kërkohej nga personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në kartelat ditore dhe regjistrin e vizitave mjekësore. Në rastet e urgjencave, me rekomandimin e mjekut të sëmurët shoqëroheshin menjëherë në Spitalin Rajonal të Korçës. Nga kontrolli i dosjeve mjekësore të shtetasve të ndaluar/arrestuar, rezultoi se, ishin hapur kartelat mjekësore (*kartelat ditore*) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për secilin prej tyre.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*", si dhe nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 *"Për Policinë e Shtetit"* ku përcaktohet se Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca: *"Paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues"*:

## REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për organizimin e punës në mënyrë që të jetë funksional intervistimi/marrja në pyetje e personave të shoqëruar/ndaluar pranë dhomës së krijuar enkas për këtë qëllim nga të gjithë oficerët e policisë gjyqësore.

2. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde "*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit.

3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës për depozitimin e provave materiale, të cilat duhet të administrohen dhe ruhen në ambiente/dhoma të ndara për këtë qëllim sipas rregullave e procedurave standarde.

4. Marrjen e masave për ndërtimin e tualeteve të ndara për gra dhe burra të pajisura me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim sipas parashikimeve në procedurën standarde "*Rregullat*

*për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.

**5.** Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi të rubrikës "*Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmve*" në "Regjistrin e personave të shoqëruar" dhe evidentimi i tyre në këtë regjistër sipas kërkesave të parashikuara në procedurën standarde *"Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit"*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 dhe sigurimin e monitorimit të vazhdueshëm të tyre si dhe nisjen e procedurave për evidentimin e përgjegjësve në lidhje me këtë çështje.

**6.** Marrjen e masave për krijimin e ambientit të ajrimit për personat e arrestuar në këtë komisariat.

**7.** Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut, Tiranë.

**8.** Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin ne ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së avokatëve mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

**9.** Marrjen e masave të menjëhershme, për lyerjen dhe dezinfektimin në mënyrë vazhdueshme të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Korçë, me qëllim garantimin e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë në këtë institucion.

**10.** Të merren masat e menjëhershme, për sigurimin e ruajtjes së pamjeve nga kamerat e sigurisë, deri në 60 ditë, sikurse përcaktohet në "Rregulloren për vendosjen dhe perdorimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjediset e brendshme dhe të jashtme, të objekteve ku ushtrojnë aktivitetin strukturat e Policisë së Shtetit".

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**
**i Mekanizmit Kombëtar**
**për Parandalimin e Torturës**
**(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI**

**d.v**